



P

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 56, datë 20.04.2021

PËR

**MIRATIMIN E PËRDORIMIT TË FONDIT PREJ 88'128'502 LEKË TË PËRFITUAR
NË ZBATIM TË VENDIMIT TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR. 213, DATË
21.03.2021 NË FORMËN E TRANSFERTËS SË PAKUSHTËZUAR NGA FONDI I
RINDËRTIMIT I BUXHETIT TË SHTETIT**

Në zbatim të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, Ligjit nr.45/2019 “Për mbrojtjen civile”, Aktit Normativ nr.9, datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, Ligjit nr.68/2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Ligjit nr. 137/2020, “Për buxhetin e vitit 2021” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 775 datë 30.09.2020 “Për përdorimin e fondit të rindërtimit nga Bashkia Durrës, miratuar në buxhetin e vitit 2020, për financimin e hartimit të projektpreventivit dhe rforcimin e hidrovorit të Durrësit”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 213, datë 31.3.2021 "Për disa ndryshime në vendimin nr. 775, datë 30.9.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për përdorimin e fondit të rindërtimit nga Bashkia Durrës, miratuar në buxhetin e vitit 2020, për financimin e hartimit të projektpreventivit dhe rforcimin e hidrovorit të Durrësit”, Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të Buxhetit”, të Udhëzimit Plotësues të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 4, datë 25.01.2021 “Për zbatimin e Buxhetit të vitit 2021”, Udhëzimit nr. 22, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarte të monitorimit të buxhetit të njëjësive të vetëqeverisjes vendore”, si dhe sipas relacionit të hartuar nga Drejtoria e Buxhetit, me propozim të Zëvendëskryetares së Bashkisë, e cila kryen funksionet e Kryetarit të Bashkisë,

KËSHILLI BASHKIAK
VENDOSI:


1. Miratimin e përdorimit të fondit prej 88'128'502 lekë, të përfituar në zbatim të Vendimit nr.213, datë 31.3.2021 të Këshillit të Ministrave "Për disa ndryshime në vendimin nr. 775, datë 30.9.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për përdorimin e fondit të rindërtimit nga Bashkia Durrës, miratuar në buxhetin e vitit 2020, për financimin e hartimit të projektpreventivit dhe rforcimin e hidrovorit të Durrësit" në formën e transfertës së pakushtëzuar nga Fondi i Rindërtimit i buxhetit të shtetit, i detajuar sipas tabelës së mëposhtme:

Gr.	Kap.	Progr-ami	Llog.ekon	Kodi i produktit	Emërtimi i projektit	Fondi në lekë	Viti 2020	Viti 2021
00	1	04960	230	94902AI	Hartim i studim projektimit për rehabilitimin e infrastrukturës së rrjetit të kullimit në zonën e Porto-Romanos_kënetë dhe sistemimi i rrjetit të ujrave të shiut në zonën urbane të qytetit të Durrësit	88,128,502	51,550,000	36,578,502


2. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar dhe Drejtoria e Buxhetit.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar.

KRYETARI KËSHILLIT BASHKIAK

Ani Dyrmishi



U shpall sot me datë 20.04.2021



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DURRËS

Nr. 292 / prot.
4



Durrës, më 21 04 .2021

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

KËSHILLIT BASHKIAK ✓

DURRËS

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr. 56 datë 20.04.2021 “Për miratimin e përdorimit të fondit prej 88’128’502 lekë të përfituar në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 213, datë 21.03.2021 në formën e transfertës së pakushtëzuar nga fondi i rindërtimit i buxhetit të shtetit”.

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI

ROLAND NASTO